



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 10

2000

Prill

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8603 datë 13.4.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KFW-së për projektin "Ndihmë në mallra VIII"	437
Ligj nr.8604 datë 20.4.2000	Për dhënien e disa stimuljeve dhe të garancive për koncesionarin, në kontratën e koncesionit të formës "ROO" të Uzinës së Superfosfatit në Laç	443
Ligj nr.8605 datë 20.4.2000	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore"	444
Vendim i KM Nr.95, datë 9.3.2000	Për përdorimin e numrit të sigurimit shoqëror për identifikimin e votuesve	446
Vendim i KM	Për fazën e dytë të regjistrimit të votuesve, për zgjedhjet e	447

Nr.210, datë 5.5.2000	organeve të qeverisjes vendore	
Udhëzim nr.2 Datë 17.4.2000	Për procedurat e fazës së parë të regjistrimit të votuesve	449
Vendim i Gj.K nr.24	Me objekt "Shfuqizimi si antikushtetues i pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.46, datë 17.2.2000 "Për shkarkimin nga detyra të Kryetarëve të Komunave Ksamil, Helmës dhe Kurjan"	450
Vendim i Gj.K nr.25	Shfuqizimi si antikushtetues i pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.46, datë 17.2.2000 "Për shkarkimin nga detyra të Kryetarëve të Komunave Ksamil, Helmës dhe Kurjan"	456

L I G J
Nr.8603, datë 13.4.2000

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KfW-SË PËR PROJEKTIN “NDIHMË NË MALLRA VIII””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e Kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KfW-së për projektin “Ndihmë në Mallra VIII””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2608, datë 25.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

MARRËVESHJE

HUAJE DATË 6.12.1999 MIDIS KREDITANSTALT FÜR EIDERAUFBAU, FRANKFURT AM MAIN, (KfW) DHE REPUBLIKA E SHQIPËRISË (HUAMARRËS) E PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE PËR

10,000,000, 00 DM

Ndihmë në mallra VIII

Në bazë të një marrëveshjeje ende për t’u përfunduar midis Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për bashkëpunimin financiar (marrëveshje qeveritare), Huamarrësit dhe KfW hyjnë në Marrëveshjen e mëposhtme të Huasë.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi

1.1 KfW do ta japë Huamarrësit një Hua në shumën
10,000,000 DM

1.2 Huamarrësi do ta përdorë huanë në mënyrë që të paguajë koston e këmbimeve valutore të ngritura nga prokurimet e shërbimeve dhe mallrave për të mbuluar nevojat aktuale të huamarrësit po aq mirë, po në atë mënyrë sa dhe këmbimet valutore për kostot lokale të transportit të sigurimeve dhe mbledhja e të gjithave, të shfaqura në lidhje me importet e financuara. Në mënyrë që shërbimet dhe mallrat të jenë të financuara kontratat e tyre duhet të ishin përfshirë pas 6 dhjetor 1999. Mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja janë të renditura në Aneksin bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje dhe duhet të përcaktohet në detaje nëpërmjet Huamarrësit dhe KfW në marrëveshje të veçantë .

1.3 Taksat dhe detyrime të tjera publike që duhet të përballohen nga Huamarrësit dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga huaja.

Neni 2
Disbursimet

2.1 Huaja duhet të disbursohet nga kthimi në një llogari që shërben si fond në dispozicion. Nga marrëveshja e veçantë Huamarrësi dhe KfW duhet të bien dakord në procedurën e disbursimit, në mënyrë të veçantë përsa i përket shumave të huasë së kërkuar nëse këto të fundit janë të përdorura për qëllimet e përcaktuara më parë.

2.2 KfW ka të drejtën të refuzojë disbursimet pas 31 marsit 2001.

Neni 3
Taksa e angazhimit, Interesi dhe Kthimi i Huasë

3.1 Huamarrësi do të paguajë taksën e angazhimit prej 1/4 % në vit mbi shumat e padisbursuara të Huasë. Taksa e angazhimit do të llogaritet për një periudhë që fillon 3 muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe përfundon në datën në të cilën disbursimet debitoen.

3.2 Huamarrësi do të paguajë interes mbi huanë 0.75% në vit. Interesi do të ngarkohet nga datat në të cilat disbursimet janë debituar në datat në të cilat kthimet janë kredituar në llogarinë e KfW të specifikuar në nenin 3.9.

3.3 Huamarrësi do të paguajë komisionin e angazhimit, interesin dhe ndonjë komision tjetër sipas nenit 3.5 çdo gjysmë viti në 30 qershor dhe 30 dhjetor për gjysmën e vitit që mbaron aty. Komisioni i parë i angazhimit detyrohet bashkë me pagesën e parë të interesit.

3.4 Huamarrësi do të paguajë huanë si vijon:

1.30 qershor2010166,000.00 DM
2.30 dhjetor2010166,000.00 DM
3.30 qershor2011166,000.00 DM
4.30 dhjetor2011166,000.00 DM
5.30 qershor2012166,000.00 DM
6.30 dhjetor2012166,000.00 DM
7.30 qershor2013166,000.00 DM
8.30 dhjetor2013166,000.00 DM
9.30 qershor2014166,000.00 DM
10.30 dhjetor2014166,000.00 DM
11.30 qershor2015166,000.00 DM
12.30 dhjetor2015166,000.00 DM
13.30 qershor2016166,000.00 DM
14.30 dhjetor2016166,000.00 DM
15.30 qershor2017166,000.00 DM
16.30 dhjetor2017166,000.00 DM
17.30 qershor2018166,000.00 DM
18.30 dhjetor2018166,000.00 DM
19.30 qershor2019166,000.00 DM
20.30 dhjetor2019167,000.00 DM
21.30 qershor2020167,000.00 DM
22.30 dhjetor2020167,000.00 DM
23.30 qershor2021167,000.00 DM
24.30 dhjetor2021167,000.00 DM
25.30 qershor2022167,000.00 DM
26.30 dhjetor2022167,000.00 DM
27.30 qershor2023167,000.00 DM
28.30 dhjetor2023167,000.00 DM
29.30 qershor2024167,000.00 DM
30.30 dhjetor2024167,000.00 DM
31.30 qershor2025167,000.00 DM
32.30 dhjetor2025167,000.00 DM
33.30 qershor2026167,000.00 DM

34.30 dhjetor2026167,000.00 DM
 35.30 qershor2027167,000.00 DM
 36.30 dhjetor2027167,000.00 DM
 37.30 qershor2028167,000.00 DM
 38.30 dhjetor2028167,000.00 DM
 39.30 qershor2029167,000.00 DM
 40.30 dhjetor2029167,000.00 DM
 41.30 qershor2030167,000.00 DM
 42.30 dhjetor2030167,000.00 DM
 43.30 qershor2031167,000.00 DM
 44.30 dhjetor2031167,000.00 DM
 45.30 qershor2032167,000.00 DM
 46.30 dhjetor2032167,000.00 DM
 47.30 qershor2033167,000.00 DM
 48.30 dhjetor2033167,000.00 DM
 49.30 qershor2034167,000.00 DM
 50.30 dhjetor2034167,000.00 DM
 51.30 qershor2035167,000.00 DM
 52.30 dhjetor2035167,000.00 DM
 53.30 qershor2036167,000.00 DM
 54.30 dhjetor2036167,000.00 DM
 55.30 qershor2037167,000.00 DM
 56.30 dhjetor2037167,000.00 DM
 57.30 qershor2038167,000.00 DM
 58.30 dhjetor2038167,000.00 DM
 59.30 qershor2039167,000.00 DM
 60.30 dhjetor2039167,000.00 DM

Total10,000,000.00

3.5 Nëse kthimet e kësteve nuk janë në dispozicion të KfW, kur janë të detyruara, KfW do të ketë të drejtën të rrisë përqindjen e interesit në përqindjen e Deutsche Bundesbank të asaj kohe plus 3% në vit për periudhën që fillon me datën e detyrimit dhe përfundon në datën në të cilën të tilla kthime kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 3.9 më poshtë. Në rastin e arrears të interesit, KfW mund të kërkojë shpërblim dëmi. Të tilla dëme nuk do të kalojnë shumë e arritur nëse interesi do të ishte ngarkuar në të tilla arrears interesi në përqindjen e Deutsche Bundesbank në datën e detyruar plus 3% në vit.

3.6 Taksa e angazhimit, interesi dhe ndonjë taksë mbi arrears sipas nenit 4.5, do të llogaritet mbi bazën e 360 ditë në vit dhe 30 ditë në muaj.

3.7 Shumat e kthyera të pamaturuara ose të padisbursuara do të kreditohen në përpjesëtime të barabarta kundër të gjitha kësteve të papaguara përveç rastit kur KfW përcakton një mënyrë të ndryshme në një rast të veçantë, veçanërisht në rastet e shumave të një volumi më të vogël.

3.8 KfW ka të drejtën të kreditojë në diskrecionin e saj, pagesat e marra kundrejt pagesave të detyruara sipas kësaj marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër të përfunduar midis KfW dhe Huamarrësit.

3.9 Huamarrësi do të kërkojë të gjitha pagesat ekskluzivisht në DM në llogarinë e KfW Nr. 22 3954 7450 tek Kreditanstalt, Frankfurt duke mos pranuar kundërkërkesa mbi këto pagesa.

Neni 4

Pezullimi i disbursimeve dhe pagesat e pamaturuara

4.1 Huamarrësi në çdo kohë mund:

- a) të anulojë ndonjë shumë të Huasë të padisbursuar ende, sipas përmbushjes së detyrimeve të tij të nenit 7, dhe
- b) të kthejë huanë tërësisht ose pjesërisht përpara maturimit.

4.2 KfW mund të mos pezullojë disbursimet përveç kur:

a) Huamarrësi nuk ka kryer detyrimet e tij ndaj KfW për të bërë pagesat kur kanë qenë të detyruara,

b) detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta që kanë lidhje me këtë marrëveshje janë shkelur,

c) Huamarrësi është i paaftë të provojë që shumat e Huasë të jenë përdorur për qëllimin e shprehur, ose

d) dalin rrethana të jashtëzakonshme të cilat pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit, ose kryerjen e detyrimeve të pagesës të ndërmarra nga Huamarrësi sipas kësaj marrëveshjeje.

4.3 Nëse ndonjë nga situatat e specifikuar në nenin 4.2 a), b), c) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda periudhës së përcaktuar nga KfW, e cila sidoqoftë do të jetë të paktën 30 ditë, KfW mund,

a) në rastet e specifikuar në nenin 4.2 a) ose 4.2 b), të kërkojë kthimin e menjëhershëm të të gjithë shumës së paguar të Huasë, si dhe pagesën e të gjithë interesit dhe taksave të tjera të rastit.

b) në rastin e specifikuar në nenin 4.2 c), të kërkojë kthimin e menjëhershëm të shumave të Huasë ndërsa huamarrësi është i paaftë të provojë që këto shuma janë përdorur për qëllimet e përcaktuara më parë.

Neni 5

Kosto dhe Taksat Publike

5.1 Huamarrësi do të paguajë të gjitha taksat dhe detyrimet të tjera publike që ndodhin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në lidhje me përfundimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, gjithë koston e transferimit dhe konvertimit që ndodhin në lidhje me disbursimet si dhe të bëjë pagesat sipas marrëveshjes pa ndonjë zbritje për taksat, për të tjera taksa publike ose të tjera kosto.

Neni 6

Vlefshmëria e Marrëveshjes dhe Përfaqësimi

6.1 Sipas radhës së duhur para disbursimit të parë, Huamarrësi do t'i dorëzojë KfW-së evidencë të kënaqshme për KfW-në që provon se Huamarrësi ka plotësuar të gjitha kërkesat sipas ligjeve të tij për një supozim të vlefshëm të të gjitha detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

6.2 Ministri i Financave të Shqipërisë dhe persona të tjerë të caktuar prej tij dhe të autorizuar për të nënshkruar duke u autentifikuar prej tij do ta përfaqësojnë Huamarrësin në ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje. Prokurat nuk do të skadojnë deri në revokimin e tyre të shprehur nga përfaqësuesi i autorizuar në kohën që është marrë nga KfW.

6.3 Amendamente ose shtesa të kësaj marrëveshjeje dhe ndonjë lajm ose dokument i dërguar nga palët kontraktuese sipas kësaj marrëveshjeje do të bëhen me shkrim. Ndonjë lajm i tillë ose dokument do të jetë marrë menjëherë sapo të ketë arritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese korresponduese ose në ndonjë adresë tjetër të palës kontraktuese korresponduese siç është lajmëruar nga pala tjetër kontraktuese.

Për KfW: Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 11 11 41
D-60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Telefax: (69) 74 31-29 44
Telex: 4 15 25 60 kë d

Për Huamarrësin: Ministria e Financave
Bulevardi Dëshmorët e Kombit
Tirana, Albania.
Telefax: (355-42) 28 494
Telex 0604 5295 komplab

Neni 7

Ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje dhe Informacioni

7.1 Huamarrësi do të:

a) mbajë ose të bëhet shkak për të mbajtur, libra dhe regjistrime të qarta duke treguar të gjitha

mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo hua;

b) paraqesë përfaqësuesve të KfW në çdo kohë për inspektim librat dhe regjistrimet e përmendura, si dhe çdo e të gjitha dokumentet lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

c) furnizojë KfW me çdo dhe të gjithë këto informacione dhe regjistra mbi ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje dhe të tregojë se kjo hua është përdorur për qëllime të caktuara;

d) informojë me vulletin e saj KfW-në për çdo dhe të gjitha situatat që pengojnë seriozisht plotësimin e kësaj marrëveshjeje ose ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje.

7.2 Për transportin e mallrave për t'u financuar nga Huaja dhe Kontributet Financiare do të aplikohen dispozitat e Marrëveshjes Qeveritare që njihen nga Huamarrësi.

Neni 8

Dispozita të Përgjithshme

8.1. Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të paprekura. Nëse rezulton ndonjë boshllëk, ai do të mbushet nga ndonjë dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

8.2. Huamarrësi dhe Agjencia e Ekzekutimit të Projektit nuk mund të ngarkojë ose transferojë, vërë peng ose hipotekë ndonjë të drejtë nga kjo Marrëveshje.

8.3. Kjo Marrëveshje do të qeveriset nga ligji i RFGJ. Vendi i lidhjes së Marrëveshjes do të jetë Frankfurt mbi Main. Në rast të ndonjë dyshimi për interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, teksti gjerman do të mbizotërojë.

8.4. Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje mbi vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje dhe asaj të Arbitrimit që nuk mund të zgjidhen miqësisht midis palëve kontraktuese do t'i nënshtrohen procedurave të arbitrazhit në përputhje me Marrëveshjen e Arbitrazhit që përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

8.5. Kjo Marrëveshje Huaje, financimi dhe projekti nuk do të hyjë në fuqi derisa të hyjë në fuqi Marrëveshja Qeveritare në të cilën ajo bazohet.

E bërë në 4 kopje origjinale, 2 në gjermanisht dhe 2 në anglisht.

KREDITANSSTALT FÜR REPUBLIC OF ALBANIA

WIEDERAUFBAUREPREFSENTED BY THE

MINISTRY OF FINANCE

E shikuar:

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare

Aneksi i Marrëveshjes së Huasë

Midis Kreditanstalt dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

1. Lista e mallrave dhe e shërbimeve të lejueshme për financimin nga huaja/ kontributi financiar sipas artikullit 1 (2) të marrëveshjes qeveritare duhet të përfshijë:

a) Materialet dhe pajisjet për stacion transformatori prej 110/35/10/kw.(përfshin transformatorët dhe instalimin)

b) Materiale shtesë për një fuqi linje prej 35 dhe 10 kw. (përfshirë dhe instalimin)

Shërbime konsulence për prokurim dhe instalim

2. Importet që nuk janë të përfshira në listën e mësipërme mund të jenë të financuara vetëm me aprovimin paraprak të Qeverisë të Republikës të Gjermanisë. Pesticidet mund të jenë të financuar vetëm në qoftë se substancat janë të garantuara.

3. Importet e mallrave të mëposhtme nuk mund të jenë të financuara nga huaja/ kontributi financiar:

a) Mallrat luksi dhe të konsumit për nevojat personale.

b) Mallra dhe lehtësira për qëllime ushtarake.

Institucionet e mbrojtjes së bimeve të kategorizuara si rreptësisht të ndaluara sipas procedurës të aplikuar PIC sipas FAO.

c) Droga, substancat fiktropike dhe ato të renditura në anekset e marrëveshjes së Konventës së Kombeve të Bashkuara të 20 dhjetor 1998 kundër trafikut të paligjshëm të drogës dhe substancave fiktropike në qoftë se ato përdoren për të prodhuar drogë ose substanca fiktropike (derisa anekset e Konventës së vitit 1998 të jenë të ndryshuara në mënyrë të përshtatshme), lista e kimikateve e bashkëngjitur raportit final të Task Force Kimikate do të aplikohet.

d) Mallrat e mëposhtme dhe substancat e rrezikshme për mjedisin hidro-klorofluorokarbon dhe halons po ashtu dhe substanca të tjera objekt i Protokollit të Montrealit dhe të tjera lehtësira për prodhimin dhe përdorimin.

Substancat e renditura në aneksin e parë të Këshillit të Rregullimit nr.245592 të 23 korrik 1992 lidhur me eksportin e disa kimikateve të rrezikshme.

f) abtestos po ashtu dhe substancat që përmbajnë abtestos.

L I G J
Nr.8604, datë 20.4.2000

PËR DHËNIEN E DISA STIMUJVE DHE TË GARANCIVE PËR KONCENSIONARIN, NË KONTRATËN E KONCENSIONIT TË FORMËS “ROO” TË UZINËS SË SUPERFOSFATIT NË LAÇ

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Shoqëria “Evertrade, Shqipëri” e themeluar prej shoqërisë franceze “Evertrade s.a.”, palë në kontratën e koncensionit në formën “ROO” me Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit për Uzinën e Superfosfatit sh.a. Laç për një afat 3-vjeçar sipas kontratës së koncensionit, përjashtohet nga detyrimet vijuese:

- nga tatim fitimi;
- nga taksa doganore dhe TVSH-ja për importin e makinerive, pajisjeve dhe të lëndëve të para për realizimin e projektit.

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të kontratës së koncensionit, detyrimet e Uzinës së Superfosfatit në Laç, prej 135 milionë lekësh, trajtohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2612, datë 28.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr.8605, datë 20.4.2000

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8093, DATË 21.3.1996 “PËR
REZERVAT UJORE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 61 shtohen tre paragrafë me këtë përmbajtje:

“Për shkeljet e parashikuara në nenin 14 pika 1 shkronja “ë” dhe në nenet 20, 24 paragrafi 1 dhe 2, 47, 48, 49 dhe 50 të këtij ligji, kundërvajtësi dënohet nga Kryetari i Degës së Policisë së Ndërtimit në rreth në varësi të shkallës së shkeljes, me:

gjobë deri në 500 lekë;

pezullim të veprimtarisë deri në 60 ditë;

c) sekuestrim të mjeteve dhe pajisjeve të punës, si dhe të materialit inert gjendje, të grumbulluar e të fraksionuar.

Policia e Ndërtimit ka të drejtë t’i propozojë sipas rastit organit kompetent heqjen e licencës profesionale dhe të lejes së veprimtarisë përkatëse të shoqërive që shkelin dispozitat e mësipërme.

Kundër vendimit të Kryetarit të Degës së Policisë së Ndërtimit në rreth bëhet ankim te Drejtori i Policisë së Ndërtimit brenda 5 ditëve nga data e komunikimit të vendimit.

Neni 2

Neni 69 ndryshohet si vijon:

“Kundër vendimit të autoritetit të ujit, si dhe kundër vendimit të Drejtorit të Policisë së Ndërtimit mund të bëhet ankim në gjykatën e shkallës së parë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.

Vendimi i autoritetit të ujit ose i organit të Policisë së Ndërtimit, që nuk ankimohet nga kundërvajtësi, quhet titull ekzekutiv.

Padia në gjykatë kundër vendimit të autoritetit të ujit ose të Drejtorit të Policisë së Ndërtimit, nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Kur gjykata vendos pranimin e padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të pësuar nga organi që ka dhënë vendimin.

Në rastet e përsëritjeve të kundërvajtjeve administrative, kur nuk bëhet ankim kundër vendimit të autoritetit të ujit ose atij të organeve të Policisë së Ndërtimit, si dhe kur gjykata rrëzon padinë e paraqitur kundër tyre, konfiskohen mjetet, pajisjet e punës dhe materiali inert gjendje i grumbulluar dhe i fraksionuar.

Gjoha, si dhe shpenzimet që përballohen nga autoriteti i ujit dhe nga organet e Policisë së Ndërtimit paguhen nga kundërvajtësit brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të tyre ose nga data kur ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës.

Përveç rasteve të parashikuara nga paragrafi i gjashtë i këtij neni, masa e sekuestrimit, e vënë mbi këto mjete dhe materiale, hiqet vetëm pasi të jenë shlyer gjocat dhe shpenzimet e përballuara nga autoriteti i ujit dhe nga organet e Policisë së Ndërtimit.

Kundërvajtësi, për çdo ditë vonesë paguan kamatë në masën 2 për qind në ditë, deri në 1 muaj. Gjocat dhe vlera e shpenzimeve të përballuara nga autoriteti i ujit dhe nga Policia e Ndërtimit paguhen

pranë organit që ka vendosur gjobën.”

Neni 3

Në nenin 60 përjashtohen nga sanksioni shkeljet në nenin 14 pika 1 shkronja “ë”.

Neni 4

Në kreun XVI, nenet 63, 65 dhe 68 shfuqizohen.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2611, datë 28.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

V E N D I M
Nr. 95, datë 9.3.2000

PËR PËRDORIMIN E NUMRIT TË SIGURIMIT SHOQËROR PËR IDENTIFIKIMIN E VOTUESVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3, shkronja “e”, e ligjit nr.7845, datë 13.7.1994, “Për numrin e sigurimit shoqëror”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e numrit të sigurimit shoqëror për identifikimin e votuesve, në Regjistrin Kombëtar të Votuesve.

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në kuadër të projektit “Asistencë për zgjedhjet”, të japë, në përdorim të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të dhënat dhe informacionin që ka në regjistrin qendror të numrit të sigurimit shoqëror, për hartimin e listave paraprake të votimit.

3. Ministria e Pushtetit Lokal, pas përfundimit të procesit të verifikimit në zyrat e gjendjes civile, e të regjistrimit të të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Votuesve, ia rikthen këto të dhëna, të azhornuara, Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

4. Ministria e Pushtetit Lokal dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të përcaktojnë, me udhëzim të përbashkët, mënyrën e këmbimit reciprok dhe të ruajtjes së dokumentacionit, të informacionit dhe të të dhënave të tjera, të kërkuara, sipas nenit 10, të ligjit nr.7845, datë 13.7.1994, “Për numrin e sigurimit shoqëror”.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve të interesuara dhe të përballohen nga fondet e siguruara për projektin e asistencës për zgjedhjet.

6. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Lokal dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.210, datë 5.5.2000

PËR FAZËN E DYTË TË REGJISTRIMIT TË VOTUESVE, PËR ZGJEDHJET E
ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992, “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrisë të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të krijohet një komision regjistrimi, në nivel bashkie e komune, me këtë përbërje: kryetari i bashkisë ose i komunës, sekretari i këshillit, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, si dhe përfaqësuesi i 4 partive politike që kanë numrin më të madh të vendeve në këshill. Kryetari i komunës ose i bashkisë është kryetar i komisionit dhe sekretari i komunës ose i bashkisë është zëvendëskryetar. Komisioni ka për detyrë të marrë të gjitha masat për pasqyrimin në regjistrat e votuesve të të gjithë shtetasve, që gëzojnë të drejtën e votës.

2. Komisionet e bashkive e të komunave, në mbështetje të qendrave të votimit, të përdorura në zgjedhjet e fundit (në referendumin e vitit 1998 për Kushtetutën), përcaktojnë territoret dhe numrat rendorë të qendrave të votimit, duke i paraqitur ato në skicë dhe në mënyrë përshkimore, ku të pasqyrohen rrugët dhe banesat që përfshihen për secilën. Bashkitë apo komunat, në territorin e të cilave ka spitale, shtëpi lindjeje, konvikte, burgje apo institucione riedukimi, duhet të parashikojnë edhe për to ngritjen e qendrës së votimit si dhe të caktojnë numrin rendor (pavarësisht se ato në këtë çast nuk do të kenë lista zgjedhësish dhe numër të përgjithshëm votuesish). Bashkitë dhe komunat, brenda 5 ditëve nga përcaktimi i qendrave të votimit, dërgojnë në Ministrinë e Pushtetit Lokal të dhënat për numrin e qendrave të votimit.

3. Komisioni i bashkisë apo i komunës, në bashkëpunim me administratat përkatëse (zyrat e gjendjes civile, lagjet administrative, kryeqendrat etj.), në bazë të përcaktimit të kufijve të territorit dhe të numrit rendor në çdo qendër votimi ndajnë, në dosje të veçanta për secilën qendër votimi, formularët e dërguar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, pasi të jenë azhurnuar e plotësuar nga zyrat e gjendjes civile.

4. Për çdo qendër votimi ngrihen grupet e punës për regjistrimin e votuesve shtëpi më shtëpi. Grupi të jetë me 3 veta, me këtë përbërje: përfaqësuesi i bashkisë apo i komunës dhe nga një përfaqësues prej dy partive që kanë numrin më të madh të vendeve në këshillin përkatës dhe të jenë njeri nga pozita e tjetri nga opozita.

5. Kryetarët e bashkive dhe të komunave t’u kërkojnë partive politike përkatëse dërgimin e përfaqësuesit të tyre në komisionin e bashkisë ose të komunës, si dhe listën emërore të përfaqësuesve të tyre në çdo qendër votimi, në përbërje të grupeve për regjistrimin shtëpi më shtëpi (sipas pikave 1 dhe 4).

6. Në bashkitë me mbi 30 000 votues, komisioni i regjistrimit të votuesve mund të emërojë një koordinator për çdo 30 000 votues.

7. Grupi i punës, brenda datës 20.5.2000, merr në dorëzim, me procesverbal, nga komisioni i bashkisë a i komunës dosjen me formularët e përgatitur nga zyra e gjendjes civile, të ndarë e të azhurnuar sipas pikës 3, si dhe një numër formularësh të regjistrimit të votuesve me banim të përkohshëm, ku do të regjistrohen votuesit e familjeve të ardhura me banim në territorin e qytetit ose të fshatit, por që nuk kanë sjellë të dhënat e regjistrimit themeltar në zyrën e gjendjes civile të bashkisë apo komunës ku banojnë sot për sot. Grupi vendos menjëherë numrin e qendrës së votimit në vendin përkatës në krye të çdo formulari.

8. Regjistrimi i votuesve kryhet, brenda datës 10 qershor 2000, nga grupi i punës i cili, me përbërje të plotë, shkon shtëpi më shtëpi. Gjatë verifikimit e regjistrimit grupi kryen këto detyra:

a) Për familjet që figurojnë në formularët e përgatitur, të azhurnuar e të marrë në dorëzim verifikon praninë e secilit votues.

Për personat që janë të pranishëm, në krahë të majtë të formularit, para emrit vihet një shenjë spostimi “V” dhe në anën e djathtë të formularit shënohet adresa.

Në rastet kur personat e regjistruar në formular ndodhen jashtë shtetit, në formular, në vendin e adresës shënohet vendi ku ndodhet, sipas deklaramit të familjarëve ose të fqinjëve, si dhe shënohet shkronja "E".

Në rastet kur personat që janë formuluar nuk janë të pranishëm në banesë kur grupi i regjistrimit bën verifikimin dhe kur merret njoftimi se nuk janë larguar, lajmërohet data dhe ora për një takin të dytë.

Në rastet kur personat që janë në formular janë larguar nga ai vendbanim dhe janë sistemuar në një vendbanim të ri, brenda vendit, emrit përkatës i hiqet vijë dhe para emrit vihet shenja "L".

Në rastet kur familjarët deklarojnë se një person i regjistruar ka vdekur, grupi e shënon veçmas këtë të dhënë. Grupi i punës bën verifikimin në zyrën përkatëse të gjendjes civile dhe nëse rezulton se personi ka vdekur në bazë të dokumentit të lëshuar nga kjo zyrë, (dokumenti i bashkëlidhet formularit), vepron në formular duke i hequr vijë emrit të personit të vdekur dhe vendos në kutinë e kolonës "jeton" shenjën "X".

b) Për familjet apo individët e ardhur me vendbanim në qytetin apo në fshatin përkatës dhe që nuk kanë sjellë në zyrën e gjendjes civile të dhënat e regjistrimit themeltar, plotësohen të dhënat që kërkohen në formularët për regjistrimin e votuesve me banim të përkohshëm, duke regjistruar tërë të dhënat e identitetit për të gjithë personat e familjes të lindur deri në datën 31.12.1983.

c) Në të gjitha rastet, identifikimi i votuesve gjatë regjistrimit shtëpi më shtëpi bëhet me njerin nga dokumentet e identifikimit, dhe konkretisht me letërnjoftimin, pasaportën për jashtë shtetit, certifikatën e lindjes apo të gjendjes civile ose me librezën ushtarake.

9. Grupi i punës, pasi ka përfunduar regjistrimi shtëpi më shtëpi paraqitet pranë komisionit të regjistrimit të bashkisë ose të komunës dhe raporton kryerjen e detyrës dhe numrin e votuesve të regjistruar.

- Në rastet kur numri i votuesve rezulton nën 1 000 veta, komisioni i regjistrimit urdhëron grupin të vendosë në çdo formular numrin e qendrës së votimit për çdo person dhe secili formular, në fund, firmoset nga të tre anëtarët e grupit. Pas kësaj dosja merret në dorëzim nga komisioni me procesverbal.

- Në rastet kur numri i votuesve rezulton mbi 1 000 vetë, komisioni vendos që në atë territor të ngrihen dy qendra votimi, duke përcaktuar edhe numrin e përgjithshëm të votuesve për secilën qendër votimi. Nga këto njëra qendër votimi duhet të ketë numrin rendor të përcaktuar nga komisioni, sipas pikës 2 të këtij vendimi, dhe tjetrës i vihet i njëjti numër rendor, por me fraksionin 1. Grupi i punës ndan formularët në dy dosje, sipas vendimit të komisionit, dhe në çdo formular, në krye të tij, vendos numrin përkatës të qendrës së votimit dhe, pasi firmosen nga të tre anëtarët e grupit, ia dorëzon komisionit të regjistrimit me procesverbal.

- Në çdo rast, kur komisioni ka vërejtje për plotësimin e formularëve, detyron grupin e punës të bëjë përmirësimet e nevojshme.

10. Komisioni i regjistrimit të bashkisë ose të komunës, pasi bën dhe mban një fotokopje të formularëve, veçmas për çdo qendër votimi, nën përgjegjësinë dhe kujdesin e kryetarit e të sekretarit, sjell, zyrtarisht dhe dorazi, në qendrën kombëtare të regjistrimit të votuesve, pranë Qendrës së Informatizimit Financiar, në Tiranë, dosjet me formularët origjinalë. Dorëzimi bëhet me procesverbal.

Dorëzimi i dosjeve të bëhet pjesë-pjesë për ato qendra votimi që përfundojnë procesin e regjistrimit, pa prituri përfundimin e kësaj detyre në shkallë bashkie ose komune, por jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes në dorëzim nga grupet e regjistrimit.

11. Prefekturat, me strukturat përkatëse, ndjekin dhe kontrollojnë respektimin e procedurave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore për regjistrimin e votuesve në bashkitë dhe në komunat e territorit përkatës.

12. Qendra kombëtare e regjistrimit të votuesve, të gjithë materialin e grumbulluar e hedh në bazën e të dhënave për krijimin e regjistrimit të votuesve për çdo bashki ose komunë dhe veçmas për çdo qendër votimi. Pasi bën verifikimin e nevojshëm, si p.sh., heqjen e rasteve kur një person rezulton i regjistruar dy herë etj, nxjerr listat e votuesve veçmas për çdo bashki e komunë, në bazë të qendrave të votimit, dhe i dorëzon ato në komisionin qendror të zgjedhjeve jo më vonë se data 25 korrik 2000.

13. Çdo anëtar i grupeve të verifikimit shtëpi më shtëpi shpërblejet nga bashkitë e komunat, me fondet që u janë dhënë atyre, në masën 7 lekë për çdo person në listë.

14. Fondi prej 55 000 000 (pesëdhjetepesë milionë) lekësh, për shpërblimin e grupeve të verifikimit, përballohet nëpërmjet projektit "Asistencë për zgjedhjet".

15. Ngarkohen bordi drejtues “Asistencë për zgjedhjet”, Ministria e Pushtetit Lokal, prefekturat, kryetarët e bashkive dhe të komunave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 2, datë 17.04.2000

PËR PROCEDURAT E FAZËS SË PARË TË REGJISTRIMIT TË VOTUESVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 3 të vendimit të Këshillit të ministrave nr.5, datë 13.01.2000 “Për miratimin në parim të projektit të asistencës për zgjedhjet elektorale” dhe të vendimit nr. 95, datë 09.03.2000 “Për përcaktimin e numrit të sigurimit shoqëror për identifikimin e votuesve”,

U D H Ë Z O J:

1. Në fazën përgatitore, për hartimin e listave të votuesve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore që do të zhvillohen në vjeshtën e këtij viti, bashkitë dhe komunat, me zyrat e gjendjes civile, të realizojnë brenda datës 30.04.2000, plotësimin e elementeve që mungojnë në formularët që do të dërgohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas modelit bashkëlidhur.

2. Për realizimin e kësaj detyre, zyrat e gjendjes civile në bashki e komuna, mbasi të hartojnë marrëveshjen (modeli bashkëlidhur) me drejtoritë apo degët rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me procesverbal, marrin në dorëzim formularët për çdo familje me vendbanim në territorin që ka në juridiksion organi përkatës i pushtetit vendor.

3. Nën drejtimin e përgjegjësit të gjendjes civile:

Organizohet puna për të plotësuar në formular: atësinë e çdo personi që është i shkruar në të.

Kontrollohet saktësia e emrit dhe mbiemrit, si dhe fshihet me një vizë, personi i larguar (martuar, vdekur, ndarë nga familja dhe ka tërhequr të dhënat e regjistrimit themeltar në një zyrë tjetër të gjendjes civile etj., pra ai që në këtë moment nuk është pjesëtar i familjes në faqen e saj të regjistrimit themeltar). Gjithë personat e tjerë që janë në fletën e regjistrimit themeltar të familjes, pavarësisht se mund të kenë emigruar, do të lihen në formular.

Shtohet në formular personat që figurojnë në faqen familjare të regjistrimit themeltar por nuk janë në formularin e dërguar.

4. Gjithë formularët e plotësuar, të grupuar veças për çdo fshat, dhe në qytete veças për çdo lagje ruhet nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, për t’ju dorëzuar komisionit të regjistrimit që do të ngrihet në çdo bashku e komunë, për fazën e dytë të regjistrimit që ka të bëjë me verifikimin shtëpi më shtëpi të zgjedhësve.

Ndërkohë Përgjegjësi i Zyrës së Gjendjes Civile, dërgon në drejtorinë rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore një njoftim zyrtar për numrin e formularëve të plotësuar për familjet që janë dërguar nga ISSH, numrin e zgjedhësve të përfshirë në to, si dhe numrin e formularëve që është plotësuar për familjet e ardhura në territorin e organit përkatës të pushtetit vendor, nga bashki e komuna të tjera, e që nuk kanë sjellë në zyrën e gjendjes civile të dhënat e regjistrimit themeltar si dhe numrin e zgjedhësve të këtij kontigjenti familjesh.

5. Me zbatimin e kësaj detyre ngarkohen përgjegjësat e zyrave të gjendjes civile, ndërsa me kontrollin e plotësimit të saj, kryetarët e bashkive e komunave, dhe prefektët.

MINISTRI I PUSHTETIT LOKAL
Bashkim Fino

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË”

Gjykata kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Sabri Rrapi,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Bardha Selenica,	Anëtare e “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““

Me sekretare Arbenka Lalica, më datë 23.03.2000 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.20 akti që i përket:

K Ë R K U E S: XHEMAL XHEMALI, i përfaqësuar nga avokat Artan Kodheli.

SUBJEKTE TE INTERESUARA: KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

MINISTRIA E PUSHTETIT LOKAL, e përfaqësuar nga zotërinjtë Blendi Vathi e Shahin Bistri.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.46, datë 17.02.2000 “Për shkarkimin nga detyra të Kryetarëve të Komunave Ksamil, Helmës dhe Kurjan.

Në kërkesë si dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, kërkuesi ka paraqitur këto shkaqe:

- Në motivacionin e Këshillit të Ministrave nuk përmendet të jetë shkelur ndonjë dispozitë kushtetuese, ashtu siç e kërkon neni 115/II i Kushtetutës. Po kështu vendimi edhe pse përmend se është shkelur Ligji nr.7572, datë 10.06.1992 nuk përcakton dispozitën konkrete të shkelur;

- Këshilli i Komunës ishte vetshpërndarë jo për shkak të veprimeve të kërkuesit dhe se kjo vetshpërndarje ka ndodhur para daljes së Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.253, datë 28.05.1999;

- Me Urdhërin nr.1, datë 08.01.1999 për transferimin e zyrove të administratës së Komunës nuk është shkelur asnjë ligj, përkundrazi prefekti i Fierit, ka konfirmuar ligjshmërinë e këtij akti;

- Nuk ka zbatuar vendimin nr.253, datë 28.05.1999, të Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e qendrës së Komunës Kurian” sepse e ka konsideruar se ishte në kundërshtim me Kushtetutën dhe për këtë shkak ka paraqitur kërkesën edhe në organet qëndrore.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuesit, subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Xhemal Xhemali, kryetar i komunës së Kurjanit, të rrethit të Fierit, është shkarkuar nga detyra, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.46, datë 17.02.2000, me këtë motivacion: “Për shkelje të rëndë të ligjit nr.7572, datë 10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, dhe të vendimit nr.253, datë 28.05.1999 të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e qendrës së komunës Kurian”, duke paralizuar kështu veprimtarinë e Këshillit”.

Sipas relacionit të Ministrit të Pushtetit Lokal, mbi bazën e të cilit është mbështetur vendimim i mësipërm i Këshillit të Ministrave, Xhemal Xhemali me veprimet e tij antiligjore ka bllokuar e dëmtuar punën e këshillit të komunës dhe aparatit të tij. Në këtë relacion si shkelje të rëndë përmenden këto fakte:

- Në fillim të vitit 1993 Xhemal Xhemali, me iniciativën e tij, ka siguruar mjedise pune, ka lëvizur dokumentacionin dhe administratën nga fshati Vlosh në fshatin Kurian. Këtë lëvizje e ka kundërshtuar dhe e kundërshton këshilli i komunës i cili nuk mblidhet prej disa muajsh si dhe ka patur protestanga ana e banorëve.

- Edhe pas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.253, datë 28.05.1999, i cili përcakton si qëndër të komunës fshatin Vlosh, zoti Xhemal nuk ka ndryshuar qëndrimin e tij.

- Gjykata Kushtetuese pasi dëgjoi pretendimet e palëve në proces dhe administroi provat shkresore të paraqitura gjatë seancës arrin në konkluzion se Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.46, datë 17.02.2000 (pika 3) për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës zotit Xhemal Xhemali është i bazuar në Kushtetutë e në ligj.

Në bazë të ndarjes administrative të Republikës së Shqipërisë të përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.269, datë 25.06.1992, qendra e komunës së Kurjanit ishte fshati Kurjan. Në fakt, qysh prej vitit 1992, e në vazhdim zyrat e administratës së komunës dhe i gjithë aktiviteti është zhvilluar në fshatin Vlosh.

Në datën 8 janar kryetari i Komunës Xhemal Xhemali nxjerr urdhërin nr.1 sipas të cilit administrata e komunës transferohej për në qendrën e fshatit Kurjan, në disa ambiente të qendrës shëndetësore. I njohur me këtë urdhër, prefekti i Fierit ndonëse pranon se sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.269, datë 25.06.1992, qendra e komunës duhet të jetë në fshatin Kurjan, kërkon që kjo lëvizje të bëhet në mirkuptim me këshillin e komunës dhe me Drejtorinë e Shëndetit Publik që e ka në pronësi godinën.

Urdhëri i mësipërm i Kryetarit të komunës është kundërshtuar në mënyrë kategorike nga shumica dërmuese e anëtarëve të Këshillit të komunës duke arritur që kjo mosmarrëveshje të shkaktojë ndërprerjen e aktivitetit të këshillit si organ, i cili qëndron i pa mbledhur qysh nga fundi i muajit janar 1999.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkuesi, me cilësinë e kryetarit të komunës ka nxjerrë një urdhër që nuk është në kompetencë të tij sipas ligjit. Lëvizja e vendqëndrimit të administratës së komunës, e cila ka lidhje të drejtpërdrejtë me funksionimin e këshillit si organ i qeverisjes vendore, në bazë të nenit 14/1 dhe nenit 14 pika 7 e 13 është kompetencë e këshillit, të cilin, siç doli nga gjykimi, kërkuesi nuk e ka përfillur.

Njëkohësisht Gjykata Kushtetuese konkludon se veprimet e kërkuesit përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit, në kuptim të nenit 115 pika 1 e kushtetutës, sepse prekin raporte të rëndësishëm siç është ai i kompetencës së organeve vendore. Është vërtetuar se me gjithë protestat e shumicës dërmuese të këshilltarëve, të ankesave të Drejtorisë së Shëndetit Publik si dhe të sugjerimeve e të këshillimeve të herëpashërëshme të të dërguarve nga Prefektura si dhe nga Ministria e Pushtetit Lokal kërkuesi nuk ka pranuar të korigjojë qëndrimin e tij. Nga ana tjetër, bllokimi i veprimtarisë së këshillit është një pasojë e rëndë e cila nuk mund të shërbejë si element i shkeljes së rëndë të ligjit. Për Gjykatën Kushtetuese kjo shkelje motivon shkarkimin e zoti Xhemal Xhemali nga detyra e Kryetarit të Komunës.

Gjykata Kushtetuese nuk e gjen me vend shkeljen tjetër që Këshilli i Ministrave i atribuon kërkuesit, atë të mos zbatimit të vendimit nr.253 datë 28.05.1999 “Për ndryshimin e qendrës së Komunës Kurjan”.

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës, ndarje administrative tokësore, e cila më parë ishte kompetencë e Këshillit të Ministrave, tani duhet të rregullohet me ligj (neni 108). Në këto kushte vendimi i lartëpërmendur ka dalë nga një organ që nuk është kompetent e për pasojë mungesa e kompetencës në nxjerrjen e një akti passjell pavlefshmërinë e tij. Për pasojë Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjejë fajtor Xhemal Xhemalin për faktin se ai nuk ka pranuar të zbatojë një akt i cili nga përmbajtja kushtetuese e ligjore ishte i pavlefshëm e për më tepër kur për këtë fakt, ashtu siç del nga materialet e çështjes, ai ka vënë në dijeni organet përkatëse.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 115 të Kushtetutës dhe të nenit 72 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 04.05.2000.
Nr. 20 i Regj. Themeltar
Nr. 24 i Vendimit.

MENDIMI I PAKICËS

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.46, datë 17.02.2000 (pika 3) me të cilin shkarkohet nga detyra kryetari i komunës Xhemal Xhemali, është në thelb kontradiktor, i pa plotë si dhe i pa bazuar në Kushtetutë dhe në ligj.

Është kontradiktor se në të dy rastet, edhe kur zbaton aktet nënligjore dhe kur nuk zbaton ato që vijnë në kundërshtim me kushtetutën, Xhemal Xhemali bëhet fajtor !!!

Është i paplotë, sepse edhe kur thuhet se kërkuesi ka shkelur rëndë ligjin nr.7572, dt.10.06.1992, nuk konkretizohet se çfarë dispozite të ligjit në fjalë ka shkelur.

Në këtë mënyrë shkelja e atribuar nuk mbështetet në dispozitë konkrete. Mjafton ky shkak për t'a bërë vendimin e mësipërm të cënueshëm.

Është krejtësisht i pamotivuar në Kushtetutë dhe në ligj për këto arsye:

Nuk mund të mohohet kursesi fakti që veprimtaria e këshillit Kurjan ka qënë për një kohë të gjatë e bllokuar gjë që padyshim përbën në vetvete një pasojë të rëndë.

Detyra e Këshillit të Ministrave dhe më pas e Gjykatës Kushtetuese ka qënë që të përcaktojë se cilat shkelje të ligjit kanë derteminuar në këtë pasojë dhe kush i ka kryer këto shkelje.

Pakica ka mendimin se Xhemal Xhemali për rastin në shqyrtim nuk ka shkelur ligjin, si në përmbajtjen e tij ashtu dhe në procedurë.

Së pari, Xhemal Xhemali, me cilësinë e kryetarit të komunës, zbatoi (edhe pse me vonesë) një vendim të Këshillit të Ministrave që përcaktonte si qendër të komunës fshatin Kurian.

Së dyti, Urdhëri i lëshuar si dhe lëvizja, nuk ishin thjeshtë shprehje e kapriçios të Xhemal Xhemalit, ashtu siç i janë atribuar atij në gjykim nga subjekti i interesuar, por detyrim ligjor për zbatimin e të cilit kanë ndërhyrë edhe organet përkatëse kompetente. Nga shkresa nr.307, datë 11.02.1999 e Prefekturës Fier dërguar Ministrisë së Pushtetit Lokal del se vetë Ministria ka udhëzuar për zbatimin e vendimit të Qeverisë për ndarjen administrative nga të gjitha organet vendore, e mbi këtë bazë edhe prefekti ka ndërhyrë.

Së treti, Prefekti i Fierit, si organ i ngarkuar me ligj për kontrollin e akteve të organeve të pushtetit vendor, urdhërin nr.1, datë 08.01.1999 të kryetarit të komunës e ka gjetur në përputhje me vendimin e qeverisë. Kjo del jo vetëm nga shkresa ku konfirmohet ligjshmëria e urdhërit por dhe nga sërë shkresash tjera të ndodhura në dosje si p.sh. nr.307, datë 11.02.1999; nr.1591, datë 21.06.1999 etj.

Së katërti, Ashtu siç del nga dokumentat në dosje, para daljes së urdhërit, Kryetari i komunës ka vënë në dijeni Këshillin. Për këtë shif shkresën e kryetarit të komunës nr.11, datë 24.12.1998 nga del fakti i informimit si dhe i vendimit për bojkotimin e mbledhjes të këshillit nga këshilltarët.

Së pesti, Nuk ka argumente në përkrahje të tezës se shkak për bllokimin e veprimtarisë së këshillit u bë zënia e ambienteve të qëndrës shëndetësore. Në dosje ka dokumenta që vërtetojnë se ndërtesa nuk ishte marrë ende në dorëzim, se asaj i ziheshin për zyra të komunës vetëm disa ambiente dhe më e rëndësishmja përkohësisht.

Së gjashti, Shumica gjen si shkelje të rëndë marrjen e kompetencave të këshillit nga kryetari i komunës, lidhur me disponimin për lëvizjen e zyrave, duke ju referuar nenit 14 pika 7 e 13 të ligjit nr.7572, datë 10.06.1992.

Duhet të nënvizojmë se ky shkak (shkelja e kompetencave) nuk është ngritur në asnjë nga materialet që përmban dosja e as gjatë zhvillimit të gjykimit nga pala e interesuar. Ngritja e një shkakut të tillë të papretenduar është e papranueshme jo më për Gjykatën Kushtetuese por edhe për gjykatat e zakonshme, sepse një ndërmarrje e tillë i jep gjykatës atributet e organit administrativ që merr masa, me fjalë të tjera e kthen gjykatën padrejtësisht nga organ që gjykon për masat disiplinore në organ që vendos masa.

Nga ana tjetër, dispozita ligjore ku mbështetet shumica s'ka të bëjë aspak me disponimin mbi zyrat e administratës por me institucionet lokale të arsimit, shëndetësisë, kulturë dhe rinisë. Për pakicën është e pavënd të identifikohen këto institucione me aparatit ekzekutiv të komunës.

Pakica ka mendimin se lëvizja e zyrave të aparatit të komunës, në përputhje dhe zbatim të

akteve ligjore e nënligjore është kompetencë ekskluzive e kryetarit të komunës i cili në bazë të nenit 33 të ligjit në fjalë drejton administratën publike kurse në bazë të nenit 34 pika 1 siguron respektimin e ligjeve dhe aktave të nxjerë në zbatim të tyre.

Duke qenë kosequente në mendimin, se në rastin e lëvizjes së zyrave nuk gjenden veprime të kundraligjshme të Xhemal Xhemalit, për të sjellë argumente të mëtejshme në këtë drejtim, po pranojmë për një moment se shkelje ka pasur si në ushtrim të kompetencave ashtu dhe në zënie e qëndrës shëndetësore. Ndaj një pranimi të tillë pyetja më normale është: Kanë qënë këto shkaqet reale e derteminante që shkaktuan bllokimin e këshillit? Ne mendojmë se jo. Për pakicën shkaku derteminant është “bojkotimi” si një veprim antikushtetues e antiligjor që ndërmorën këshilltarët e tre fshatrave (Vlosh, Ngjëqar, Mbërs) si kundër përgjigje ndaj zbatimit të vendimit të Qeverisë dhe porosive të organeve qëndrore. Parë në këtë këndvështrim problemi shtrohet në parim: a do të pranohet në shtetin tonë që aspirojnë për shtet ligjor, “bojkotimi” si mjet reagimi ndaj veprimeve, qofshin këto dhe të paligjëshme, por që kanë mjete dhe rrugë normale për t’u atakuar. Problemi është edhe më i qartë po t’u referohemi dokumentave konkrete që përmban dosja.”Bojkotimi” është përdorur paraprakisht si mjet presioni qysh kur kryetari informoi këshillin se do zbatonte ligjin. Për këtë shif vendimin nr.11, datë 24.12.1998. “Bojkotimi” u bë fakt i kryer më vonë duke shkaktuar bllokimin e veprimtarisë së këshillit dhe kjo nuk u bë pse u zunë përkohësisht disa ambiente shëndetësore dhe as se u shkelën kompetencat, por thjesht për faktin se zyrat shkuan atje ku duhet të ishin me kohë, por që një pjesë të këshilltarëve nuk u intresonte.

Së shtati, Si shkak për bllokimin e veprimtarisë së këshillit të komunës, Këshilli i Ministrave pranon edhe moszbatimin e vendimit nr.253, datë 28.05.1999, vendim të cilin edhe shumica e pranon se është antikushtetues. Për pasojë, me të drejtë pranohet se Xhemal Xhemali nuk mund të vihet para përgjegjësisë për moszbatimin e një akti antikushtetues. Megjithatë duke lënë në fuqi masën e shkarkimit, shumica nuk merr parasysh: - se moszbatimi i këtij akti inicoi procedimin disiplinor ndaj kërkuesit (shih dëshminë e përfaqësuesit të Prefekturës, faqe 12 të procesverbalit; si dhe shkresën nr.1841, datë 16.07.1999 që Prefektura i dergon Ministrisë së Pushtetit Lokal, ku propozohet shkarkimi i Xhemal Xhemalit se “qëllimisht nuk do të zbatojë Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.253, datë 28.05.1999...” Në këto kushte në mënyrë të natyrshme për shumicën shtrohet pyetja: Për çfarë pasaje bëhet përgjegjës Xhemal Xhemali pasi nuk mund të justifikohet shkelja e atribuar, atëhere edhe “bllokimi” i këshillit për periudhën maj 1999 e më pas llogjikisht e ligjërish s’mund të pranohet se ka rrjedhur nga veprimi (i ligjshëm) i Xhemal Xhemalit (që spranoi të zbatojë një akt antikushtetues).

Tiranë, më 04.05.2000

A N Ë T A R
Z. Vuci

A N Ë T A R
A. Karamuço

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa duhet të ishte pranuar sepse në veprimet e kërkuesit nuk ka shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve.

Sipas nenit 115 të Kushtetutës, organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësive qeverisëse vendore mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. Ky përcaktim kushtetues ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të veçantë të organeve të zgjedhura vendore, duke garantuar njëkohësisht parimet e rëndësishme të decentralizimit dhe autonomisë vendore, të sanksionuara në nenin 13 të Kushtetutës. Këto organe të zgjedhura drejtpërdrejt të njësive të qeverisjes vendore, siç është edhe kërkuesi në detyrën e kryetarit të komunës, nuk mund të shkarkohen për çdo lloj shkeljeje. Për shkarkimin e tyre duhet të plotësohen dy kushte: a) shkeljet të jenë të rënda dhe b) shkeljet të jenë të Kushtetutës ose të ligjeve dhe jo të akteve nënligjore. Kjo për faktin se në këtë nen si dhe në shumë dispozita të tjera Kushtetuta e përdor fjalën “ligje” në kuptimin e ngushtë, pa përfshirë aktet nënligjore. Kur kemi të bëjmë me këto të fundit në dispozita të veçanta është përdorur termi “akte nënligjore” pa lënë shteg për keq interpretime.

Motivacioni i shkarkimit të kërkuesit Xhemal Xhemali nga detyra e kryetarit të komunës së Kurjanit është për shkelje të rëndë të ligjit nr.7572, datë 10.06.1992 Për Organizimin dhe

Funksionimin e Pushtetit Lokal dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.253, datë 28.05.1999 “Për ndryshimin e qendrës së Komunës Kurjan”. Shkarkimi për shkelje të vendimit të Këshillit të Ministrave është krejtësisht i pabazuar për arsye se: 1) Vendimi nuk është botuar në Fletoren Zyrtare dhe sipas nenit 117 të Kushtetutës nuk ka marrë fuqi juridike; 2) në nenin 108 të Kushtetutës përcaktohet se ndarjet administrative teritoriale të njërive të qeverisjes vendore caktohen me ligj. Pra vendimi i Këshillit të Ministrave është nxjerrë jashtë kompetencës dhe si i tillë është i paqenë, nul; 3) Edhe sikur vendimi t’i kushtet e mësipërme, përsëri Kushtetuta e lidh shkarkimin me shkelje të rënda të ligjeve dhe jo të vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Përsa i përket shkeljes së ligjit nr.7572, datë 10.06.1992, në vendimin e shkarkimit nuk thuhet se cila dispozitë konkrete është shkelur. Megjithatë, duke iu referuar relacionit përkatës, del se kërkuksi është shkarkuar, sepse ka paralizuar veprimtarinë e këshillit të komunës. Është e vërtetë se këshilli i komunës nuk ka funksionuar, por për këtë nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi kërkuksi, vetëm për faktin se sipas ligjit këshilli thirret nga Kryetari i Komunës. Shkaku i vërtetë i mosmbledhjes së këshillit është se kërkuksi lëvizi qendrën e administratës duke e çuar në Kurjan dhe për këtë antarët e këshillit bojkotuan mbledhjen. Në rast se ata do të kishin vullnetin e mirë për t’u mbledhur e për të vazhduar veprimtarinë e këshillit, nuk është bërë pengesë kërkuksi, sepse në bazë të nenit 16 të ligjit nr.7572, datë 10.06.1992, mbledhja mund të thirrej edhe me kërkesë të 1/3 anëtarëve. Në këto rrethana nuk mund të thuhet se kërkuksi është përgjegjës për pezullimin e veprimtarisë së këshillit dhe se ka shkelur rëndë ligjin.

Duke iu referuar përsëri kërkesave të nenit 115 të Kushtetutës që shkarkimi mund të bëhet vetëm për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjit, kam mendimin se kërkesa duhet të ishte pranuar nga Gjykata Kushtetuese.

Tiranë, më 04.05.2000

A N Ë T A R
K. Peçi

V E N D I M “NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapë,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Alfred Karamuco,	Anëtar i “““
Bardha Selenica,	Anëtare e “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““

Me sekretare Arbenka Lalica , në datat 28.03.2000 dhe 03.04.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.21 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: SADIK RECI

SUBJEKTE TE INTERESUARA: KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

MINISTRIA E PUSHTETIT LOKAL, përfaqësuar nga zotërinjtë Blendi Vathi dhe Shahin Bistri.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.46, datë 17.02.2000 “Për shkarkimin nga detyra të Kryetarëve të Komunave Ksamil, Helmas dhe Kurjan”.

Kërkuksi në detyrën e Kryetarit të Komunës së Helmasit të rrethit Kavajë, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të mësipërm të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, duke arsyetuar se,

- Vendimi i Këshillit të Ministrave është haptazi i padrejtë dhe i pabazuar në Kushtetutë dhe në ligj;

- Të gjithë veprimtarinë time si Kryetar i Komunës e kam bazuar në dispozitat ligjore në fuqi;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nuk përmend asnjë fakt që të vërtetojë se ku konsistojnë shkeljet e kryera nga ana ime.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi kërkuesin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, administroi të gjitha materialet e çështjes dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Mbi propozimin e Ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave me vendimin nr.46, datë 17.02.2000, në bazë të neneve 100 dhe 115 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka shkarkuar nga detyra e Kryetarit të Komunës së Helmasit në rrethin e Kavajës kërkuesin, për shkelje të rënda të Ligjit nr.7572, datë 10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” dhe të Ligjit nr.7573, datë 16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal.

Nga kontrollet e organizuara nga Prefektura e Rrethit Tiranë dhe nga Ministria e Pushtetit Lokal në Komunën e Helmasit të rrethit Kavajë, ka rezultuar se veprimtaria e organeve të pushtetit vendor në këtë komunë ka qenë e bllokuar për një periudhë të gjatë kohe, duke sjellë edhe çrregullime në këtë njësi të qeverisjes vendore. Për subjektet e interesuara shkaqet kryesore që kanë sjellë këto parregullsia, kanë qenë veprimet e vazhdueshme të kryera në kundërshtim me ligjin nga ana e kërkuesit, të cilat janë parashtruar edhe në relacionin përkatës që i është dërguar Këshillit të Ministrave dhe që ndodhet në dosje.

Gjykata Kushtetuese konkludon se përgjegjësia kryesore për mosfunksionimin e organeve të zgjedhura në Komunën e Helmasit qëndron tek veprimet e paligjshme të kryera nga kërkuesi Sadik Reci, shkelje të cilat konsiderohen të rënda dhe me pasoja për veprimtarinë e organeve të qeverisjes vendore.

Kërkuesi ka shkelur rëndë dhe sistematikisht kërkesat e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”. Këshilli i komunës është organ përfaqësues në njësinë e qeverisjes vendore, ndërsa kryetari i komunës është organ ekzekutiv, i cili përgjigjet dhe raporton përpara këshillit. Sipas nenit 33 të këtij ligji “Kryetari i komunës ... është përgjegjës përpara këshillit për funksionimin e saj të mirë”, ndërsa në bazë të nenit 34, pika 4, ai “... i raporton këshillit çdo 6 muaj ose kurdoherë që kërkohet...”.

Nga dosja gjyqësore dhe nga të gjitha materialet e paraqitura nga palët në gjykim, nuk rezulton që kërkuesi të ketë marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Komunës Helmas për vitin 1999 për të raportuar së paku 2 herë në vit, siç e kërkon neni 34, pika 1 e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal.

Gjithashtu megjithëse në tematikën e mbledhjeve të Këshillit të Komunës Helmas për vitin 1999, ishte planifikuar miratimi i projektbuxhetit lokal për vitin 2000 në muajin Gusht, kërkuesi në kundërshtim me nenin 34, pika 5 të ligjit nuk ka përgatitur dhe as ka paraqitur atë për miratim në këshill. Kërkuesi me veprimet që ka kryer ka spostuar dhe paralizuar punën e Këshillit të Komunës, duke mos përfillur për veprimtarinë e këtij organi të zgjedhur nga populli.

Duke iu referuar dokumentave që ndodhen në dosje, rezulton se ai ka caktuar thirrjen e mbledhjes së Këshillit të Komunës me datë 24.08.1999, pa njoftuar kryetarin e këshillit të komunës, në të cilën është vendosur shkarkimi i tij dhe emërimi në këtë detyrë i zëvendëskryetarit të Këshillit të Komunës. Në këtë mbledhje të këshillit janë njoftuar për të marrë pjesë edhe për të plotësuar quorumin e nevojshëm pesë anëtarë të këshillit dhe një person tjetër i quajtur Ruzhdi Celhaka, të cilin sipas pretendimit të kërkuesit në seancë gjyqësore ia kishte paraqitur me një shkresë Komisioni i Mandateve të komunës për të zëvendësuar këshilltarin që ishte larguar përpara mbarimit të mandatit për arsye dorëheqjeje. Siç vërtetohet nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kërkuesi, një pretendim i tillë i tij nuk provohet, sepse personi që mori pjesë në mbledhjen e këshillit si anëtar i gjashtë nuk i është paraqitur kryetarit të Komunës me shkresë nga Komisioni i Mandateve, siç kërkon neni 84 i Ligjit “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, por nga Skënder Kazazi, në cilësinë e Kryetarit të ri të zgjedhur të Këshillit të Komunës, në një kohë që në këtë funksion ky i fundit është zgjedhur dhe me votën e Ruzhdi Celhakës. Nga verifikimi i listës së kandidatëve për anëtarë të këshillit të Komunës Helmas, e paraqitur nga subjekti elektorale përkatës, rezulton se emri i Ruzhdi Celhakës nuk figuron në

këtë listë.

Thirrja dhe organizimi i mbledhjes së Këshillit të Komunës nga ana e kërkuesit Sadik Recit në kundërshtim me ligjin, duke pranuar paraqitjen si këshilltar të një personi tjetër që nuk figuron në listën elektorale dhe aq më tepër jo nga Komisioni i Mandateve, me qëllim votimin në këtë këshill, përbën një shkelje të rëndë të ligjit.

Nisur nga përmbajtja e nenit 115, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilës Këshilli i Ministrave mund të shkarkojë organin e njësisë së qeverisjes vendore të zgjedhur drejtëpërdrejt, Gjykata Kushtetuese çmon se kuptimi i saktë dhe i drejtë i konceptit shkelje e rëndë e ligjit të përdorur në këtë dispozitë kushtetuese vlerësohet në tërësinë e saj nga disa faktorë që kanë të bëjnë me rëndësinë e ligjit të shkelur, pasojat e ardhura nga shkelja e tij, kohëvazhdimin e këtyre pasojave, si dhe vetë qëndrimin subjektiv që mban personi konkret ndaj shkeljes së kryer.

Në këtë këndvështrim të problemit, të gjitha shkeljet e sipërcituara të vlerësuara në kompleks krijojnë bindje të plotë për Gjykatën Kushtetuese se kërkuesi Sadik Recit qëllimshëm ka shkelur rëndë vetë ligjin, duke krijuar vështirësi të shumta dhe me pasoja të rënda në veprimtarinë e organeve të pushtetit vendor të kësaj komune.

Gjykata Kushtetuese, duke u mbështetur në të gjithë dokumentacionin dhe provat që ndodhen në dosje, si dhe duke vlerësuar faktin se pretendimet e kërkuesit nuk mbështeten në prova dhe njëkohësisht nuk provuan përpara saj të kundërtën e pretendimeve dhe provave të paraqitura nga subjektet e interesuara, të cilat në shumicën e tyre vërtetuan se shkeljet e kryera nga ana e Kryetarit të Komunës së Helmasit janë të rënda, çmon se Vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkimin e tij nga detyra është i mbështetur në Kushtetutë dhe në ligj dhe për rrjedhojë kërkesa e tij duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 115 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në nenin 72 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I :

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 04.05.2000

Nr. 21 i Regj.Themeltar.

Nr. 25 i Vendimit.

NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare nr.4, Mars 2000, ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në faqen 106, në nenin 21, rreshti i tretë:

është “ose një pjesë e tij,” të bëhet “ose nga një pjesë e saj,”

Doli nga shtypi më 9.5.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 150 lekë